

Vendim nr. 49 datë 19.03.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, në datën 19.03.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERVIN TRASHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3339, datë 12.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Ervin Trashi (*kërkuesi*), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka depozituar kërkesë për të konkurruar për pozicionin vakant të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë, të shpallur nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*ish-KLD*). Në mbledhjen e datës 16.09.2016, ish-KLD-ja ka marrë në shqyrtim dhe ka votuar për kandidaturat e paraqitura për pozicionin e shpallur vakant për gjyqtar dhe në përfundim të procesit të votimit ka vendosur me shumicë votash t’i propozojë Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*) emërimin e

kërkuesit si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në vijim, Presidenti nuk është shprehur në lidhje me propozimin e ish-KLD-së, ndërkohë që në mbledhjen e datës 04.11.2016, ish-KLD-ja ka vendosur të rishpallë edhe njëherë pozicionin vakant për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

2. Në këto rrethana, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të Presidentit për rrëzimin në heshtje të kandidaturës së tij për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 491 (80-2017-494), datë 15.02.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj, me arsyetimin se nga ana e Presidentit nuk është shkelur asnjë dispozitë e ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 9877/2008*), për sa i përket mosdekretimit të kërkuesit. Kundër këtij vendimi, në datën 16.03.2017, kërkuesi ka paraqitur ankim, përmes të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31015-01649-86-2017 akti, datë 03.04.2017.

4. Kërkuesi ka depozituar kërkesë për përsheptimin e gjykimit të çështjes në datën 14.01.2021, e cila është pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërkohë që planifikimi për shqyrtimin e çështjes është bërë për në datën 14.09.2023.

5. Kërkuesi në datën 03.07.2023 i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurës së gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këtë kërkesë, ndër të tjera, kërkuesi ka parashtuar se çështja nuk ishte gjykuar edhe pse kishin kaluar 6 vjet e 3 muaj nga data e regjistrimit të saj. Po kështu, nuk rezultonte që ajo të ishte e pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të tij. Gjykata Administrative e Apelit nuk ishte në pamundësi objektive dhe mungesa e gjyqtarëve nuk justifikonte kalimin e afateve ligjore.

6. Kërkuesi, i cili ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 84/2016*). Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kërkuesit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*KPK*), me vendimin nr. 474, datë 12.11.2021, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (*KPA*), i cili, me vendimin nr. 48, datë 15.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të *KPK*-së.

7. Në lidhje me procesin gjyqësor që i referohej konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3339, datë 12.09.2023, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se çështja ishte planifikuar për t'u gjykuar në dhomën e këshillimit nga Gjykata Administrative e Apelit në datën 14.09.2023. Në këto kushte, ai ka vlerësuar se çështja ka mbetur pa objekt dhe duhet të pushohet. Lidhur me këtë vendimmarrje, ky kolegji është mbështetur në nenin 399/7, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sipas të cilit në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës, organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës pushon shqyrtimi i çështjes.

8. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili është regjistruar në datën 20.12.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Kolegji i Gjykatës në datën 01.03.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi:

9.1.1.1. Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e çështjes me argumentin se Gjykata Administrative e Apelit kishte planifikuar datën e shqyrtimit të saj, ndërkohë që çështja nuk ishte gjykuar ende në kohën e paraqitjes së kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, megjithëse kishin kaluar 6 vjet e 3 muaj nga regjistrimi i saj në gjykatën e apelit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.04.2017 dhe ajo është gjykuar në datën 14.09.2023, tej afatit 30-ditor të përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së.

9.1.1.2. Gjykata e Lartë kishte detyrim të shprehej për themelin e çështjes, në kushtet kur: (i) nuk rezultonte që kërkesa të ishte pezulluar nga Gjykata Administrative e Apelit ose të ishte shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese

dhe nuk konstatohej ndonjë sjellje e palëve që të kishte ndikuar në kohëzgjatjen e procesit; (ii) çështja nuk paraqitej komplekse nga natyra e saj, pasi kishte të bënte vetëm me interpretim të ligjit dhe nuk kishte nevojë për hetim gjyqësor (*mbledhje provash*) dhe me një seancë gjyqësore, gjykata mund të dispononte për padinë; (iii) mosshqyrtimi i kësaj çështjeje gjyqësore me argumentin e ngarkesës në punë të gjyqtarëve nuk justifikon tejkalimin e afatit të arsyeshëm ligjor, që sjellë, si pasojë, humbjen e efektivitetit të pritshëm të kësaj vendimmarrjeje. Gjykata nuk ishte në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe, pasi gjatë kësaj kohë ajo ka shqyrtuar çështje të tjera të regjistruara më pas në kohë se sa ankimi i kërkuarit; (iv) tejzgjatja e procedurave gjyqësore paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e tij. Gjykata e Lartë nuk duhej ta pushonte çështjen, pasi konstatimi i tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit ka efekt dhe ndikim në të drejtat e tij si në aspektin moral, ashtu dhe në atë financiar. Evidentimi i shkeljes së këtij afati i jep atij të drejtë që të pretendojë për të drejtat që njeh ligji procedural dhe ai material për dëmin që rrjedh nga gjykimi me vonesë i një çështjeje gjyqësore duke cenuar të drejtën e tij për të kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e gjykimit të çështjes. Në këtë kuptim, pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuarin.

9.1.2. *Parimit të objektivitetit të gjykimit dhe paanshmërisë në gjykim*, pasi gjyqtarja E. M. ka qenë relatores në gjykimin e themelit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën ai ka ngritur pretendime për shkelje të afatit të arsyeshëm të gjykimit. Po kështu, kjo gjyqtare ka shqyrtuar edhe kërkesën për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm të çështjes në gjykimin e saj. Gjyqtarja në fjalë nuk ka hequr dorë kryesisht nga gjykimi i kësaj çështjeje, si një nga parakushtet procedurale për të vazhduar gjykimin. Ndërkohë që kërkuari ka qenë në pamundësi objektive për të kërkuar përjashtimin e saj, pasi nuk ka qenë në dijeni të përbërjes së trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, në momentin e njoftimit të vendimit, me të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të kërkesës së tij. Në këtë moment kërkesa e tij për përjashtimin e saj do të ishte joefektive. Paraqitja e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues, pasi çështja ishte gjykuar, do të ishte një ankim

joefektiv, për pasojë kërkuesi nuk mund të konsiderohet se nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e nevojshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

9.2. E drejta për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos shqyrtuar në themel pretendimin e kërkuesit për konstatimin e shkëljes së afatit të arsyeshëm, ka sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së tij për të kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e gjykimit të çështjes. Vonesa prej 7 vjetësh për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, i jep të drejtë atij të kërkojë kompensimin financiar të parashikuar me ligj. Në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me ligj, ndaj nuk mund të pranohet kufizimi i saj me vendim gjyqësor.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Në drejtim të legjitimitimit *ratione personae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se me vendimin nr. 474, datë 12.11.2021 të KPK-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 48, datë 15.12.2022 të KPA-së, kërkuesi është shkarkuar nga detyra e magjistratit dhe nuk e ushtron më funksionin gjyqësor. Në bazë të kësaj rrethane të re, në gjykimin e themelit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 567 (86-2023-828), datë 14.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes, duke arsyetuar se gjykimi në apel për këtë shkak mbetet pa lëndë shqyrtimi. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5535, datë 04.12.2023 ka disponuar për mospranimin e rekursit të kërkuarit, pasi ai nuk ngrinte asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

12. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se nga data 03.07.2023, në të cilën kërkuari ka depozituar kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, deri në datën 20.12.2023, në të cilën ai ka depozituar ankim kushtetues individual në Gjykatë, ai nuk e gëzonte më statusin e gjyqtarit, si pasojë e shkarkimit të tij nga KPK-ja dhe KPA-ja.

13. Në këndvështrim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuari nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij, në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga kohëzgjatja e procesit të themelit, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.¹

14. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

¹ Gjyqtarët Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Sander Beci votuan për moskalimin e kërkesës me arsyetim paralel. Sipas tyre, plotësohet kriteri *ratione personae*, pasi nga ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, në datën 03.04.2017 deri në datën 12.11.2021, kur KPK-ja ka marrë vendimin e shkarkimit, kërkuari ka qenë bartës i interesit kushtetues dhe real për shqyrtimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Po kështu, plotësohet dhe kriteri i shterimit të mjeteve efektive, ndërkohë që, duke iu referuar legjitimitetit *ratione materiae*, bazuar në kriterin kushtetues të “rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuari” nga tejkzgjatja e procesit gjyqësor, kërkuari nuk ka pasur interes veçanërisht serioz, të tillë që tejkzgjatja t’i rrezikonte humbjen e së drejtës ose dëm serioz të interesave të tij, për më tepër që me vendim të KPA-së që nga viti 2022 e ka humbur dhe statusin e gjyqtarit. Për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet *ratione materiae*, ndaj dhe kërkesa është haptazi e pabazuar, mbështetur në nenin 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr.8577/2000.

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.